



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202002017/9

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për kthimin e sendeve personale të sekuestruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan shtetasve të huaj me iniciale M.M, H.A, M.M, M.N, A. R, A Xh dhe A. J.*

**Drejtuar:** **PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHAKLLËS SË PARË  
ELBASAN**

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME**

**TIRANË**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT  
TIRANË**

**Për dijeni:** **Znj. Jona DIVIDI**  
**Drejtor Ekzekutiv Qendra "Tirana Art"**

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa nr. K4/119-2 prot, datë 23.04.2020, e dërguar nëpërmjet Qendrës "Tirana Art", lidhur me 5 shtetas sirianë, të cilët kanë hyrë ilegalisht në datë 22 Shkurt 2020, në Shqipëri. Në datën 23 Shkurt 2020, ata janë ndaluar nga Policia e Elbasanit, dhe u janë sekuestruar të gjitha mjetet personale, si veshmbathje, telefona dhe çdo mjet tjetër që u gjet, duke mos ia kthyer më. Ata kanë pretenduar se nuk kanë asgjë për t'u ndërruar, asnjë veshmbathje, pasi të gjitha kanë qenë në valixhet e sekuestruara nga Policia e Elbasanit.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka nisur një hetim administrativ për verifikimin e këtij rasti. Fillimisht, Institucioni i Avokatit Popullit ju drejtua Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, me shkresë nr. K4/I19-2 prot, datë 23.04.2020,

Drejtorja Vendore e Policisë Elbasan, me shkresën nr.9493/1 prot, datë 04.05.2020, na informoi se, në datën 22.02.2020, rreth orës 21:30 është marrë njoftim nga salla operative e Komisarariatit të Policisë Gramsh, se në fshatin Çekrez, të Gramshit, në aksin rrugor Korçë-Gramsh ka ndodhur një aksident rrugor me pasojë vdekjen e dy shtetasve dhe plagosjen e disa të tjerëve. Shërbimet policore kanë shkuar në vendin e ngjarjes dhe kanë konstatuar se automjeti tip foristradë Benz Mercedes ML, me targa AA163 UG, ndodhej në anë të rrugës i dëmtuar. Aty janë konstatuar që dy shtetas të huaj (sipas informacioneve paraprake me shtetësi dhe kombësi siriane) kishin ndërruar jetë. Gjithashtu, drejtuesi i automjetit së bashku me shtetas të tjerë të huaj ishin të plagosur. Të plagosurve ju është dhënë menjëherë ndihma e parë duke i dërguar në spitalin e Traumës Tiranë. Dhe më pas është informuar grupi hetimor, i cili ka bërë kqyrjen e vendit të ngjarjes, sekuestrimin e automjetit, si dhe sendet të tjera që i përkasin shtetasve të huaj.

Ndër të tjera, Drejtorja Vendore e Policisë Elbasan na informoi se të gjitha sendet e sekuestruara si: një çantë e vogël lëkure në formë portofoli, ku brenda në të ndodheshin 6 (gjashtë) kartmonedha euro të prerje 50 euro; një çantë shpine e madhe e zezë, me shirit ngjyrë portokalli, me mbishkrim kryesor “Just do it”, ku brenda në të ndodheshin tesha të ndryshme, vegla tualeti, fisha karikuese dhe një palë këpucë; një çantë shpine me ngjyrë të kuqe dhe të zezë me stampim kryesor “OR&MI Fashion”, ku brenda në të ndodheshin 9 (nëntë) paketa cigare ëiston, një çakmak i bardhë, tesha të ndryshme; një çantë e vogël krahqafe, ngjyrë e zezë, ku brenda së cilës kishte një portofol të vogël, brenda së cilit ndodheshin një kartë banke “Alpha Bank” me numër 5356 7100 0311 3720, dy mbajtëse ambalazhi për kartën sim wind, një dokument në gjuhën greke në emër “Saad weaheed Jubair”, fisha të ndryshme karikimi; një çantë e vogël ngjyrë e zezë me stampim “Seven Teen” ku brenda së cilës ndodheshin furnizues për karikim telefoni, fisha të ndryshme, një dokument identifikimi, etj. Për shkak të kushteve shëndetësore nuk është bërë e mundur marrja e shpjegimeve rreth hetimit të shtetasve të huaj, dhe është vijuar me sekuestrimin e telefonave dhe pikërisht: Aparat telefoni i tipit Huawei me kod të hapjes me gisht. Aparat telefoni Iphone 6, Aparat telefoni i tipit Samsung Galaxy S-7 me ekran të dëmtuar që u përket shtetasve të huaj. Të gjithë sendet e sekuestruara në kuadër të këtij procedimi janë dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe janë vlerësuar në mënyrën e kërkuar nga ligji procedural penal nga prokurori i çështjes dhe se procesverbalet e sekuestrimit dhe vendimet e vlerësimit të sekuestrimit ndodhen në dosjen penale nr.333/2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Institucioni i Avokatit të Popullit iu drejtua me shkresën nr.K4/I9-5 prot, datë 09.04.2021 Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me qëllim për të marrë një informacion në lidhje me sendet e sekuestruara në kuadër të këtij procedimi. Meqenëse kaloi afati ligjor dhe nuk na u dërgua përgjigjja e kërkuar, me shkresën nr. K4/I19-6 prot, datë 09.06.2021, iu drejtua përsëri këtij organi me kërkesë në lidhje me pretendimet e ngritura pranë institucionit tonë nga Qendra “Tirana Art”. Gjithashtu në këtë shkresë kërkuam që të na viheshin në dispozicion edhe dokumentacioni përkatës lidhur me procedimin penal të filluar nga organi i prokurorisë për rastin në fjalë. Ndërkohë i sugjeruam, që të shikohej mundësia e kthimit të sendeve personale (të paktën veshjet), në rast se nuk cënohej procesi hetimor.

Pas kërkesës tonë të përsëritur, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me shkresën nr. 6777 prot, datë 15.07.2021, ndër të tjera na informoi se, ky institucion më datë 22.02.2021 ka dërguar për gjykim procedimin penal nr.333 të vitit 2020 në ngarkim të të pandehurit M. Gj, i akuzuar për veprën penale të “Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/4 i Kodi Penal në dëm të të dëmtuarve A. J, M. M, M. N, A.Xh, H. A, A. R, K. A. Kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan dhe gjykimi në lidhje me këtë procedim nuk ka përfunduar ende. Bashkëlidhur përgjigjes ky organ na dërgoi edhe kopjen e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq.

Pas një hetimi administrativ të kësaj ankese të shtetasve të huaj drejtuar institucionit tonë nëpërmjet Qendrës “Tirana ART”, shqyrtimit të përgjigjeve të dërguara nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, konstatojmë se:

1. Sekuestrimet e sendeve të përshkruara më sipër janë bërë nga oficerët e policisë gjyqësore A. E dhe G.V procesverbalet përkatëse të përpiluara në datën 23.02.2020 gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes. Në procesverbalin e mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore G.V, përveç aparateve të telefonit celularë, janë sekuestruar edhe veshmbathjet (rroba e këpucë), pajisje tualeti, rripa pantallonash, çanta lëkure si portofol, kartmonedha të prerjeve 10, 20, 50 euro, fisha karikuese telefoni, paketa cigaresh, karta banke, të cilat shërbejnë për plotësimin e nevojave personale e vetjake të shtetasve të huaj.

Sipas procesverbalit të sekuestrimit, ky veprim është bazuar në nenet 300<sup>1</sup> dhe 301<sup>2</sup> të Kodit të Procedurës Penale. Sjellim në vëmendje se veprimi procedural i sekuestrimit në procesin penal është një nga mjetet e rëndësishme të kërkimit të provës, me anë të të cilit realizohet kufizimi i përkohshëm, deri në një vendim përfundimtar të prokurorit ose gjykatës, i të drejtave pasurore të një personi mbi një send të caktuar, nëpërmjet marrjes së tij ose nëpërmjet detyrimit për të mos i ushtruar të drejtën kur sendet nuk mund të merren.

---

<sup>1</sup> Neni 300 “Verifikimet e ngutshme në vend” parashikon se:

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojnë para ndërhyrjes së prokurorit, kur ai ka njoftuar se do të marrë pjesë.

2. Kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale.

<sup>2</sup> Neni 301 “Vleftësimi i sekuestror” parashikon se:

1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja.

2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 72 orë, të pandehurit, mbrojtësit dhe personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t’i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestror.

Ligjshmëria në kryerjen e sekuestrimit është lidhur ngushtë me respektimin e kushteve dhe kritereve ligjore të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Nëse përmbajtja e nenit 300 të Kodit të Procedurës Penale do të kuptohej, në mënyrë korrekte, të paktën këto sende personale nuk duhet të ishin sekuestruar si prova materiale, sepse nuk kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale, mbi to nuk janë gjetur gjurmë të veprës penale, apo të jenë produkt i veprës penale.

Ne mendojmë se sekuestrimi i veshmbathjeve (rroba e këpucë), pajisjeve të tualetit, rripat e pantallonave, çantave, kartmonedhave të prerjeve 10, 20, 50 euro, fishave karikuese të telefonit, paketave me cigare, kartave bankare në këtë rast nga oficeri i policisë gjyqësore G.V është rrjedhojë e moskuptimit të saktë nocionit të provës materiale të parashikuar në nenin 187<sup>3</sup> të Kodit të Procedurës Penale.

2. Nga përgjigjja dhe dokumentet e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan nuk rezulton që nga ky organ të jetë zbatuar detyrimi i parashikuar në nenin 301/2 të Kodit të Procedurës Penale të cituar më sipër për vleftësimin e sekuestrimit të sendeve personale shtetasve të huaj të bërë nga oficerët e policisë gjyqësore të përmendur më lart.

Ne mendojmë se, nëse nga organi i prokurorisë do të ishte bërë vleftësimi i sekuestrimit të sendeve personale nga oficeri i policisë gjyqësore për veshmbathjet, pajisjet e tualetit, rripat e pantallonave, çantat si portofol, kartmonedhat e prerjeve 10, 20, 50 euro, fishat karikuese telefoni, paketat e cigareve dhe kartat bankare, do të mund të korigjohesh veprimi jo korrekt dhe jo i bazuar i tij dhe ato do t'u ishin kthyer poseduesve të tyre.

3. Në rastin që po trajtojmë, nga organi i Prokurorisë nuk janë zbatuar as nenet 217/1<sup>4</sup> dhe 218/3<sup>5</sup> të Kodit të Procedurës Penale. Ndonëse ka kaluar pothuajse një vit e gjysëm nga ndodhja e ngjarjes dhe sekuestrimi i sendeve personale të shtetasve të huaj të përfshirë në ngjarjen tragjike të ndodhur me ta, nga ky organ nuk është urdhëruar kthimi i sendeve

---

<sup>3</sup> Neni 187 “Kuptimi i provës materiale” parashikon se:

1. Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes.

<sup>4</sup> Neni 217 “Kthimi i sendeve të sekuestruara” parashikon se:

1. Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestrimit për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyer.

<sup>5</sup> Neni 218 “Rregullat për kthimin e sendeve të sekuestruara” parashikon se:

3. Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori. Kundër këtij urdhri të interesuarit mund të bëjnë ankim në gjykatë.

(veshmbathjeve e sendeve të tjera) të cilat janë të panevojshme dhe pa asnjë interes për procedimin penal nr.333, të vitit 2020 të regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ndaj shtetasit M.Gj. Ndërkohë ky veprim ka cenuar edhe të drejtën pasurore mbi sendet që dispononin këtë shtetas.

4. Në rastin e sekuestrimit të sendeve personale të përshkruara më sipër, të shtetasve të huaj nuk është mbajtur parasysh as aspekti human. Nuk duhet të harrojmë se ata janë njerëz të cilët janë larguar nga vendi i tyre në kërkim të një jete më të mirë. Ata mund të kenë pasur trauma personale, familjare dhe sociale për shkak të luftimeve apo ngjarjeve tragjike që kanë ndodhur në vendet e origjinës së tyre. Prandaj, ndodhur në këto rrethana, kur ata janë në pamundësi ekonomike dhe larg familjarëve të tyre, sekuestrimi i sendeve personale, si veshmbathjet, pajisjet e tualetit, rripat e pantallonave, çantat si portofol, kartmonedhat e prerjeve 10, 20, 50 euro, fishat karikuese telefoni, paketat e cigareve, kartat bankare, por edhe aparatet e telefonit celular për një kohë relativisht të gjëtë, ua shton hallet dhe vështirësitë atyre. Ata përveç se mbeten pa veshje për t'u ndërruar dhe sendet e tjera të cilat u shërbejnë për plotësimin e nevojave personale e vetjake, shkëpusin edhe lidhjet me familjarët e tyre nga që, numrat e telefonëve të tyre ndodhen në aparatet e telefonit. Ndaj kësaj kategorie duhet që nga strukturat ligjzbatuese shtetërore të zbatohen detyrimet për respektimin e të drejtave ligjore të garantuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe legjislacioni ynë i brendshëm, pavarësisht faktit nëse ata kanë hyrë apo qëndrojnë në vendin tonë në mënyrë të rregullt ose jo. Përveç zbatimit të detyrimeve ligjore, ndaj tyre duhet të demonstrojmë një sjellë dhe qasje dashamirëse njerëzore, të jemi më të ndjeshëm dhe t'ju vijmë në ndihmë.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63 të pikës 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme për kthimin e sendeve materiale të sekuestruara të shtetasve të huaj, *M. M, H. A, M.M, M. N, A. R, A.Xh, A. J*, si dhe veshmbathje të ndryshme, portofol, rrip, kartmonedha të prerjeve 10, 20, 50 euro, pajisje tualeti, aparate telefoni celularë, fisha karikuese dhe një palë këpucë, paketa cigaresh, kartë banke, në zbatim të nenit 217 të Kodit të Procedurës Penale.

2. Zbatimin me korrektesë të neneve 300 dhe 301 të Kodit të Procedurës Penale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët në të gjitha rastet sekuestrimit të sendeve dhe për vleftësimin e sekuestrove.

3. Përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para, me qëllim mos përsëritjen e këtyre veprimeve në të ardhmen.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkohet të vihem në dijeni, brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**ERMONELA XHAFI**